



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KUVENDI

Komisioni për Edukimin dhe Mjetet e Informimit Publik

(Dekument Parlamentar)

Tiranë, më 3. 11.2020

RAPORT

PËR PROJEKTLIGJIN

“ PËR BUXHETIN E VITIT 2021 ”

-Hyrje

Komisioni për Edukimin dhe Mjetet e Informimit Publik, në cilësinë e Komisionit për dhënie mendimi, në disa seanca të mbledhjeve të tij, *online*, të datave 30 tetor 2020 dhe 2,3 nëntor 2020, mori në shqyrtim në parim projektligjin “Për Buxhetin e Vitit 2020”. Kjo nismë është propozim i Këshillit të Ministrave.

Relatore e projektligjit është znj. Lindita Nikolla.

Në diskutimin në parim të projektligjit ishin të pranishme dhe dhanë shpjegime rreth tij Znj.Evis Kushi, Ministre e Arsimit, Sportit dhe Rinisë; znj.Elva Margariti, Ministre e Kulturës; znj. Anila Denaj, Ministre e Financave dhe Ekonomisë, si dhe ekspertë të ministrive përkatëse. Gjithashtu u organizuan seanca dëgjimore me institucione që financohen edhe nga Buxheti i Shtetit.

I.BAZA KUSHTETUESE E PROJEKTLIGJIT

Projektligji i paraqitur për shqyrtim është propozuar nga Këshilli i Ministrave, sipas përcaktimeve të neneve 81-83, të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë dhe shoqërohet me relacionin përkatës sipas nenit 80 të Rregullores së Kuvendit.

II.QËLLIMI, PËRMBAJTJA DHE RISITË E PROJEKTLIGJIT

2.1. Qëllimi i projektligjit:

Sipas relacionit shoqërues, që në fillim theksohet se Projektbuxheti 2021 synon rimëkëmbjen ekonomike të vendit, pas dy fatkeqësive natyrore, si tërmeti i 26 nëntorit 2019 dhe pandemia e shkaktuar nga COVID -19 përmes skemave të punësimit, mbështetjes pro-aktive ndaj biznesit, rindërtimit të plotë të banesave të qytetarëve të prekur nga tërmeti, si dhe marrjen e masave parandaluese të përhapjes së mëtejshme të COVID-19.

Në projektbuxhetin e vitit 2021, **programimi i të ardhurave buxhetore** mbështet synimet e Qeverisë për rimëkëmbjen ekonomike, si dhe mbajtjen nën kontroll të defiçitit buxhetor dhe borxhit publik. Në përputhje të plotë edhe me rregullat fiskalë, në ligjin organik të buxhetit, politika fiskale do të vijojë të orientohet drejt konsolidimit fiskal në periudhën afatmesme dhe afatgjatë etj..

2.2. Risitë e projektligjit

Risitë e projektligjit reflektohen në një sërë treguesish të projektbuxhetit të Vitit 2020.

Pas recesionit të fortë në vitin 2020, ekonomia pritet të rikuperohet në vitin 2021 dhe të vijojë trendin pozitiv në periudhën afatmesme.

*Rritja ekonomike dhe punësimi do të mbështetet edhe nga objektivi tjetër i planifikuar në këtë buxhet, ai i sigurimit të një niveli të lartë të **investimeve publike prej 7.2% e PBB.***

Qëndrueshmëria e financave publike përbën një tjetër fundament tejet të rëndësishëm për perspektivën e ekonomisë.

Projekti i qeverisë shqiptare për rindërtim është unik në llojin e vet, krahasuar me eksperiencat e ngjashme në vendet e tjera të botës dhe reflektim i drejtpërdrejtë i qasjes solidare me njerëzit, por edhe përgjegjësisë politike, institucionale dhe humane të një qeverie me qytetarët e saj.

Buxheti i MASR 2020

Buxheti për arsimin, sportin dhe rininë vazhdon trendin rritës si në vlera nominale, ashtu dhe në përqindje ndaj produktit të brendshëm bruto për vitin 2021, duke garantuar edhe përmbushjen e të gjitha objektivave dhe angazhimeve të Qeverisë, por duke reflektuar padyshim edhe të gjitha masat e marra për kapërcimin e pasojave të tërmetit të 26 nëtorit dhe situatës së pandemisë Covid-19.

Fondet për sektorin e arsimin në vitin 2021 janë 75 miliardë e 850 milionë lekë, duke pësuar rritje prej 36.3% në krahasim me 2020. Fondet përfaqësojnë 12.9% ndaj shpenzimeve të buxhetit apo 4.51 % ndaj produktit brendshëm bruto.

Fondet buxhetore për MASR për vitin 2021 janë planifikuar 43 miliardë e 314 milionë lekë, që në krahasim me fondet e rishikuara të vitit 2020 kanë një rritje prej 1 miliardë e 745 milionë lekë ose 4.2%.

Buxhetit të MASR-së për vitin 2021 do t'i shtohet edhe shtesa e pagave prej 15% për të gjithë punonjësit mësimorë, e cila është planifikuar të fillojë nga data 1 Janar 2021

Arsimi parauniversitar:

Fondet për arsimin parauniversitar janë 58 miliardë e 352 milionë lekë, rritje prej 35.9% në krahasim me 2020.

Fondet e MASR për investime kapitale në vitin 2021, janë planifikuar 2 miliardë e 999 milion lekë ose 9.7% e fondeve të miratuara për arsimin parauniversitar, me një rritje prej 1 miliard e 40 milionë lekë ose 11.3% ndaj vitit paraardhës

Në arsimin parauniversitar për periudhën afatmesme 2021-2023 synohet sigurimi i rritjes së aksesit të fëmijëve në arsimin parashkollor në masën 86%, ndjekja e arsimit bazë (nga 100% e moshës 6-16), përfshirja me përparësi e grupeve vulnerabël, ofrimi i teksteve shkollore falas për nxënësit që ndjekin arsimin bazë (në vitin 2021 do përfshihen në skemë edhe nxënësit e klasës 8 dhe 9), si dhe tekste shkollore falas për nxënësit nga shtresa sociale në nevojë në arsimin e mesëm të lartë; shtimi në vitin 2021 i 400 edukatoreve, shtimi i mësuesve ndihmës, trajnimi çdo vit i 9.000 mësuesve të klasave 4 dhe 9 për kurikulën e re; krijimi i një infrastrukture të qëndrueshme, gjerësisht të përdorshme të burimeve digjitale në shkolla; përmirësimi i rezultateve në vlerësimet kombëtare dhe ndërkombëtare (PISA;TIMS); sigurimi i transportit të 30-32 mijë nxënësve për ndjekjen e arsimit parashkollor dhe bazë që mësojnë në një distancë prej më shumë se 2 km nga vendbanimi i përhershëm i tyre, si dhe i rreth 9-12 mijë mësuesve që punojnë mbi 5 km nga vendbanimi; projekte për ndërtime të reja, rikonstruksion, rindërtim që do financohen për afro 100-120; rikonstruksion, rindërtime, ndërtime të reja të objekteve arsimore në Tiranë, Durrës dhe Lezhë nga fondi i Rindërtimit etj..

ARSIMI PROFESIONAL DHE PUNËSIMI.

Buxheti i planifikuar për Programin e Arsimit të mesëm profesional, për vitin 2021 është 3 miliard e 295 milion lekë, me një rritje me 4.1% më shumë se vitin e kaluar.

Programi buxhetor i Arsimit të mesëm profesional për vitin 2021 synon të përmbushë objektivat e vendosura në Strategjinë Kombëtare e Punësimit dhe Aftësive 2019 –2022 në planin e veprimit të saj për fushën e AFP –së. Dixhitalizimi është bërë një element i rëndësishëm i tregut të punës. COVID-19 imponoi ndryshime në zhvillimin dhe implementimin e politikave të reja në fushën e AFP-së e sidomos në dixhitalizimin e sistemit të AFP. Realizimi i një procesi mësimor cilësor; rishikimi i programeve ekzistuese dhe hartimi i programeve të reja në përputhje me parimet e barazisë gjinore dhe gjithpërfshirjes; rritja e numrit të nxënësve me aftësi të kufizuara që ndjekin studimet në shkollat e mesme profesionale etj.; rritja e numrit të të punësuarve pas diplomimit në shkollat e mesme profesionale.

Në vitin 2021 do ketë rikonstruksione të reja të shkollave Hoteleri - Turizëm dhe shkollës “Herman Gmainer” në Tiranë; do vijojë rikonstruksioni i shkollave të mesme profesionale "Beqir Çela", Durrës; “Sali Ceka”, Elbasan; “26 Marsi” Kavajë; “Nazmi Rushiti” Peshkopi etj..

Për arsimin e lartë dhe kërkimin shkencor

Për vitin 2021, buxheti i arsimit të lartë dhe kërkimit shkencor (pa përfshirë fondet jashtëbuxhetore) është planifikuar në një vlerë totale prej 11 miliardë e 476 milionë lekësh.

Buxheti 2021 i MASR për programin buxhetor “**Arsimi i Lartë**” ka shënuar një **rritje prej 7,6% ose 767 milion lekë** më shumë sesa buxheti 2020, rritje e cila është orientuar kryesisht në shpenzimet kapitale, të cilat janë **rritur me 84%**, krahasuar me vitin 2020. Gjithashtu, edhe buxheti i vitit 2021 i MASR për programin buxhetor “**Kërkimi Shkencor**” ka një **rritje me 25,9% ose 140 milionë lekë** më shumë krahasuar me vitin 2020.

Prioritetet e Qeverisë në arsimin e lartë :”Pakti për Universitetin” synon: rritja e cilësisë së mësimdhënies nëpërmjet kualifikimit shkencor të stafit akademik; garantimi i aksesit në bazë të meritës dhe rritja e dimensionit social në arsimin e lartë, duke mbështetur me bursë financiare individët që duan të

ndjekin studimet në arsimin e lartë nga kategoritë sociale në nevojë, në përputhje me parimet e barazisë gjinore; nxitja e punës kërkimore në IAL publike nëpërmjet financimit të drejtpërdrejtë të 3,500 kërkuesve, ku prioritet kanë femrat në përputhje me parimet e barazisë gjinore, si dhe mbështetje financiare për kërkim fundamental në IAL publike me fonde nga buxheti i shtetit; zgjerimi i bashkëpunimit të Universiteteve me biznesin privat në Programet Kombëtare të Kërkimit dhe Zhvillimit; rritja e aplikimeve me 15-20% më shumë në programin “Horizon 2020”, program për Kërkimin dhe Inovacionin (2014 - 2020); financimi me përparësi për ngritjen e infrastrukturës dhe investimet në kampuset universitare; fondi i mbështetjes studentore, për të mbuluar shpenzimet për bursat e studentëve nga shtresat sociale në nevojë, si dhe studentëve ekselentë në IAL publike, si dhe përjashtimi apo reduktimi nga tarifave vjetore e shkollimit për studentët e ekselencës apo studentët të kategorive sociale në nevojë; mbështetje financiare për studentët dhe shkencëtarët e rinj të shkëlqyer; vazhdim i ndërtimit të godinës së fakultetit të inxhinierisë së Ndërtimit dhe Inxhinierisë Elektrike & Mekanike, Universiteti Politeknik; vazhdimi i ndërtimit të godinës së Fakultetit të Bioteknologjisë në Universitetin Bujqësor; fonde grand për IAL-të publike për të financuar përmirësimin e infrastrukturës në IAL të publike për projekte të reja. Në vitin 2021 është parashikuar të fillojnë punimet për ndërtimin e Kampusit të Universitetit të Tiranës, Universitetit të Arteve dhe Akademisë së Rendit, për sigurimin e kushteve më të mira për studentët në kuadër të “Paktit për Universitetin”.etj

Për sportin dhe rininë për periudhën 2021-2023 sporti dhe rinia janë prioritet i Qeverisë Shqiptare. Parashikohet sigurimi i mbështetjes financiare për federatat Olimpikë në aktivitete Europiane, Botërore, Ballkanike në funksion të kualifikimeve për Lojërat Olimpikë Japoni 2021, mbështetja financiare për Ekipin Kombëtar Olimpik pjesëmarrës në Lojërat e Olimpikë Japoni 2021, si dhe aktivitetet kombëtare dhe ndërkombëtare për Federatat Sportive, në të gjithat disiplinat sportive, në përputhje me parimet e barazisë gjinore; mbështetja financiare me investime në sport, për ndërtimin/rindërtimin e objekteve sportive; rritja e mbështetjes financiare për shpërblimin e sportistëve elitare, fitues në aktivitete ndërkombëtare, përmirësim i cilësisë së jetës së të rinjve, përmes rritjes së pjesëmarrjes së tyre në punësim, në informim, në edukim dhe në vendimarrje; rritja e pjesëmarrjes/ mbështetjes financiare të organizatave rinore në projekteve rajonale dhe të BE (RYCO, ERASMUS +, etj);

Për vitin 2021 një miliard shtesë vetëm grand i federatave, duke u shtuar 100/100 buxheti i federatave. Nga 94 milionë këtë vit në vitin 2021 do ketë 300 milionë për investime.

Buxheti për Ministrinë e Kulturës

Për Ministrinë e Kulturës dhe institucionet në varësi të saj, viti 2020 ka qenë një vit i pazakontë, si rrjedhojë e goditjes së rëndë nga tërmeti, dëmeve të shkaktuara në rreth 60 monumente të kulturës, dëme që u thelluan me pandeminë Covid -19, si rrjedhojë e mbylljes së parqeve arkeologjike, muzeve etj.. Këto vështirësi manifestohen dhe pas hapjes së 18 majit, në kushte tepër specifike, që pavarësisht ndryshimit të tarifave për vizitat në qendrat e trashëgimisë kulturore, të ërduhurat janë të pakta.

Gjithsesi Ministria e Kulturës edhe në këto kushte i ka dhënë prioritet projekteve të rikonstruktimit, restaurimit, projekte që vijnë edhe gjatë vitit 2021. Ka përfunduar rikonstruksioni i Teatrit të Operas dhe Baletit; vijon rikonstruksioni i Kishës së Shën Ilias në fshatin Stegopull në Gjirokastrë, kishës së Shenepremtes në fshatin Dajç.

Me krijimin me VKM të “Fondit për kujdesin e Trashëgimisë Kulturore” dhe caktimin e Institutit Kombëtar të Trashëgimisë Kulturore, si njësi zbatuese të projekteve emergjente, janë krijuar mundësi për të operuar me programe operacionale që gjejnë flaksibilitet. I tillë është përdorimi i fondit të rindërtimit për financimin e restasurimit e rindërtimit të pasurive kulturore në vlerën prej 236, 6 milionë lekë, për të cilin janë hartuar 38 projekte të detajuara, të ndarë në 26 zona, për objekte dhe monumente kulture në bashkitë Durrës, Tiranë, Krujë, Mirditë, si dhe rishikimin e projekteve për Galerinë e Arteve, Bibliotekën Kombëtare, Muzeun Historik Kombëtar etj.. Po kështu për vëzhgime e sondazhe arkeologjike fond të veçantë në zonat arkeologjike etj..

Investimet janë shtuar në vlerën prej 149 milion lekë, për një shtesë fondi për një nga projektet, restaurimi i fondit të Bibliotekës Kombëtare, aneksi i vjetër, Biblioteka e Vjetër, ka hyrë në fazën e restaurimit, që do implementohet edhe në 2021-shin, por do bëhet dhe rehabilitimi, do shtohen salla të reja dhe në aspektin e teknologjive, për të pasur një qasje sa më aktive edhe të të rinjve. Janë hartuar 15 projekte ndriçimi për kalatë, nga të cilat ato të Shkodrës, Beratit, Krujës dhe Gjirokatrës implementohen brenda këtij viti buxhetor. Krahas fondit për resturimin e “Kullës së Inglizit”, projekt madhor është ai i muzealizimit të Mësonjëtores së parë shqipe. Investimi i restaurimit emergjent të Mësonjëtores nga Qeverisë Shqiptare, i përfunduar pas tërmetit që preku Qarkun e Korçës, tani është në fazën e dytë për implementimin e komplet linjës së re muzeale, një muze i ri dhe bashkëkohor, që ruan traditën, por edhe shton shumë aspekte teknologjike.

Krahasimisht me projektbuxhetin e vitit 2020, projektbuxheti i vitit 2021 ka një zbritje prej 2.2% ose 50.2 milion lekë, rritje paraqitet vetëm në zërin investime me vlerë prej 213 milion lekësh.

Shpenzime në Programin e Artit dhe të Kulturës, krahasuar me vitin 2020 janë zbritur 21.5% ose 27.4 milionë lekë. Me këtë zë shpenzimesh janë parashikuar të realizohen kryesisht një rrjet aktivitetesh që synojnë në konsolidimin e vlerave artistike, promovimin e Artit Shqiptar në arenën ndërkombëtare, si dhe mbështetje e aktiviteteve kulturore në mbarë vëndin etj..

Këto shpenzime në Programin e Trashëgimisë Kulturore krahasuar me vitin 2020 janë zbritur 20.1% ose 14 milionë lekë, fonde të cilat janë parashikuar të përdoren për mbulimin e **gjithë aktiviteteve në fushën e trashëgimisë materiale dhe jomateriale**.

Referuar tavanëve për vitin 2021, përsa i përket zërit të investimeve të brendshme, Ministria e Kulturës do të përqëndrohet:

-Në programin e Artit dhe Kulturës:

1-Do të fillohet “Restaurimi, Rikonstruksioni dhe Rehabilitimi i hapësirave në Muzeun e Arteve të Bukura” (Galeria Kombëtare e Arteve), është planifikuar të ketë një vlerë totale prej 1.4 miliardë lekë, projekt që do të shtrihet përgjatë viteve 2021-2023.

2-Do të vijohet “Rijetësimi i Piramidës, Tiranë”, është planifikuar të ketë një vlerë totale prej 1.19 miliardë lekë, projekt që do të shtrihet përgjatë viteve 2020-2022.

3-Do të vijojë “Restaurimi për ndërtesën e Fondit të Bibliotekës Kombëtare, (Faza2)” është planifikuar të ketë një vlerë 30 milionë lekë për vitin 2021.

-Në programin e Trashëgimisë Kulturore dhe Muzetë

-Do të fillojë “Restaurimi i “Kisha e Shën e Premtes”, Lukovë me vlerë 4 milionë lekë, me qëllim nxjerrjen nga zona e riskut etj..

III. KONSULTIMI PUBLIK I PROJEKTLIGJIT

Komisioni mbështetur në nenin 36, pika 1 dhe nenin 80, pika 2 të Rregullores së Kuvendit, në kuadër të gjithëpërfshirjes, transparencës dhe konsultimit publik, ka realizuar seanca dëgjimore me aktorë të interesit, si: Akademinë e Shkencave, Akademinë e Studimeve Albanologjike, RTSH-në, ATSH-në, QKK-në, universitetet publike, si në Tiranë dhe në rrethe, Drejtorinë e Përgjithshme të Arkivave etj..

Akademia e Shkencave vlerëson shqyrtimin e vëmendshëm të projektbuxhetit të Akademisë së Shkencave për vitin 2021.

Në raport me parashikimin në projektbuxhetin e Vitit 2021, Akademia si institucioni publik më i lartë, që përfaqëson e mbart vlerat më të mira të shkencës, të kërkimit shkencor, të krijimtarisë dhe të debatit e bashkëveprimit të mendimit shkencor në vend, përmes një bashkësie të zgjedhur shkencëtarësh e krijuesish, **kërkon një shtesë prej 20 milionë lekësh**, që lidhet me zbatimin e misionit dhe detyrave kryesore të saj, sipas ligjit nr. 53/2019 “Për Akademinë e Shkencave në Republikën e Shqipërisë”, që është baza e reformës institucionale.

Gjatë vitit 2021 do të ndërmerren disa aktivitete me rëndësi, siç është Kuvendi i Studimeve Albanologjike (në bashkëpunim me Akademinë e Shkencave dhe Arteve të Kosovës); Kongresi Botëror i Nanoteknologjisë etj.. Është parashikuar realizimi i një sërë projektsh madhore në shkencat kombëtare, si përgatitjet për hartimin e Enciklopedisë Shqiptare, Fjalorit të madh të Gjuhës Shqipe dhe të Historisë së Popullit Shqiptar.

Në bazë të ligjit nr.53/2019 “Për Akademinë e Shkencave në Republikën e Shqipërisë”, pranë Akademisë së Shkencave janë krijuar dy njësi të reja kërkimore, që i përgjigjen kërkesave imediate për to, duke qenë se nuk ekzistojnë fushat e tyre as në nivelin e mësimdhënies universitare: *bioshkencë* dhe *nanoteknologji*. Për rastësi, të dyja këto fusha lidhen drejtpërdrejt me përballimin e përgjegjësive institucionale në kushtet e pandemisë së shkaktuar nga *Covid-19*.

Mbajtja e *Kongresit Botëror të Nanoshkencës* lidhet jo vetëm me ngritjen e kësaj njësie të re, jo vetëm me vijimin e punës së realizuar me pesë projekte të këtij viti, por edhe me personalitetin e akademikut Arben Merkoçi, i cili është në krye të *leadership*-it shkencor botëror. Me autoritetin e tij ai ka mundësuar krijimin e një rrjeti ndërkombëtar të kërkuesve të kësaj fushe, duke përfshirë kryeqendra të tilla shkencore, si Japonia dhe Spanja. Kongresi do të trajtojë problematikën e ndërlikuar të përgjegjësive shkencore të nanoteknologjisë në kushtet e pandemisë.

Kuvendi i Studimeve Albanologjike mbahet për të vlerësuar arritjet dhe problemet e albanologjisë sot në vend dhe në Botë. Kuvendi i fundit me këtë problematikë është mbajtur

para një gjysmë shekulli. Prej asaj kohe kanë ndryshuar qendrat studimore, shkollat, tezat, kundërtezat. Është e domosdoshme që albanologjia e brendshme të ballafaqohet me dinjitet me albanologjinë e jashtme, të përballojë debatet e nxitura prej qëllimesh joshkencore dhe të vlerësojë dijetarët miq të vendit tonë.

Pse janë propozuar projektet: *Enciklopedia shqiptare, Fjalor i madh i gjuhës shqipe dhe Histori e popullit shqiptar?*

Jemi i vetmi vend me dy fjalorë enciklopedikë (një në Shqipëri e një në Kosovë), por pa enciklopedi kombëtare. Kemi enciklopedi krahinash dhe fisesh, por jo enciklopedi të botës shqiptare, me karakter konfirmues dhe integruës. Ideja e Enciklopedisë Shqiptare është propozuar që në vitet 1980. Disa herë është nisur dhe ka mbetur në mes. Tani është arritur marrëveshja me Akademinë e Shkencave dhe Arteve të Kosovës (ASHAK), për të punuar bashkë. Si rregull, edhe vendet ballkanike kanë institute të posaçme për enciklopedinë kombëtare. Hartimi i saj do të zgjasë së paku pesë vjet. Buxheti i kërkuar për vitin e ardhshëm na lejon të ngremë redaksinë qendrore dhe dy redaksitë paralele në Prishtinë dhe në Tiranë; të miratohet platforma dhe të caktohen redaksitë e fushave, të cilat do të fillojnë menjëherë nga puna.

Fjalori i madh i gjuhës shqipe është, gjithashtu, një projekt i nisur që në vitet 1980, për të njëjtën arsye. Gjuha shqipe është e vetmja në Ballkan pa një fjalor të madh, me 100-120 mijë fjalë. Kushtet për hartimin e këtij fjalori janë. Marrëveshja me ASHAK është arritur. Gjuhët e tjera kanë arritur deri tek fjalorët *thesaurus*. Për ne ky është hapi i domosdoshëm. Platforma e këtij fjalori është miratuar. Botimi i tij i jep zgjidhje një problemi tjetër, në prag të 50-vjetorit të *Kongresit të Drejtshkrimimit* (1972), njësimi të gjuhës letrare në nivelin leksikor.

Historia e popullit shqiptar, pas shumë bisedimesh me ASHAK, është konkluduar të jetë një histori sintetike, që i drejtohet kryesisht lexuesit të huaj, me qëllim që të shndërrohet në pikë reference studimore për albanologët e huaj, të cilët deri më sot i referohen një botimi të ngjashëm në vitet 1980, me autorë A. Budën, S. Pollon dhe K. Frashërin.

Komisioni mbështetet kërkesën e Akademisë së Shkencave për shtesë fondi prej 20 milionë lekësh, për realizimin me efektivitet të veprimtarisë së saj.

Akademia e Studimeve Albanologjike ka vlerësuar projektligjin “Për Buxhetin e Vitit 2021”, por njëkohësisht parashtrori një sërë çështjesh, që lidhen me funksionimin e saj, duke dhënë të detajuar kërkesa për vitin 2021, që konsistojnë në:

	Në Lekë	
	Viti 2020	Viti 2021
-Shpenzime për honorare	7,776,000	40,000,000

-Shpenzime për seminare dhe konferenca	500,000	20,000,000
-Shpenzime për dieta brenda dhe jashtë vendi	600,000	12,500,000
-Shpenzime për sigurimin dhe ruajtjen e objektit	7,585,000	16,000,000
-Shpenzime për publikime profesionale (botime të librave)	6,000,000	6,000,000
-Shpenzime të planifikuara për akreditimin institucional të ASA për vitin 2021	1,000,000	

RTSH

Buxheti i Përgjithshëm i RTSH- së për vitin 2021 është parashikuar në vlerën 2,270 milionë lekë, nga të cilat: vlera 570 milionë lekë është financimi nga Buxheti i Shtetit për katër programet ose 64 milionë lekë më pak se buxheti i vitit 2020; vlera 1,700 milionë lekë është financim nga të ardhurat e vetë RTSH-së.

Sipas projekteve në projektbuxhetin e vitit 2021, për RTSH-në janë parashikuar fondet në vijim:

FINANCIMI BUXHETOR RTSH	<i>Parashikimi vitit 2021 (në milion lekë)</i>
Shërbimi për shqiptarët jashtë kufirit e shërbimi në gjuhë të huaj	220
Prodhime filmike ose veprimtari artistike mbarëkombëtare	60
Orkestra Simfonike RTSH dhe Kinematografisë	60
Projekte Teknike për Futjen e Teknologjive të Reja	230
TOTALI	570

B -Financimi buxhetor në milionë lekë gjatë katër viteve të fundit dhe vitit 2021 paraqitet në vijim:

TË ARDHURAT	Viti 2017	Viti 2018	Viti 2019	Viti 2020	Viti 2021
Financimi nga buxheti	865	765	624	634	570
Shërbimi për Shqipt.jashtë e shërb.gjuhë të huaj	245	240	240	270	220
Projekte filmike & artistike	63	65	74	60	60
Orkestra Simfonike RTSH	57	60	60	54	60

Projekte teknike, investime dhe mirëmbajtje	500	400	250	250	230
---	-----	-----	-----	-----	-----

Nisur nga kërkesat e domosdoshme që duhen realizuar projektet dhe veprimtaritë në vijim gjatë vitit 2021, RTSH kërkon shtesë në Buxhetin e Shtetit për këtë institucion në vlerën 336 milionë lekë.

1.Për programin “Shërbimi për shqiptarët jashtë kufirit e shërbimi në gjuhë të huaj” kërkohet shtesë e financimit buxhetor në masën 50 milionë lekë.

2.Për programin Orkestra Simfonike e RTSH-së.

Për vitin 2021, kërkohet shtesë e financimit buxhetor në masën 16 milionë lekë.

3.Për projekte teknike për futjen e teknologjive të reja, sipas dy drejtimeve kryesore në vijim:

a)Në projektet teknike emergjente për veprimtarinë e përditshme kërkohet shtesë financimi në vlerën 70 milionë lekë “Për Shërbimin e mirëmbajtjes së rrjetit të digjitalizimit”.

b.Për Investimet në teknologji në projekte afatgjata, i rishikuar në këtë material, kërkohet shtesë financimi në vlerën minimale 200 milionë lekë.

Nga sa më sipër shtesat në investime konsistojnë në vlerën 270 milionë lekë në vitin 2021.

RTSH kërkon një shtesë financimi buxhetor për vitin 2021,

Në milionë lekë

FINANCIMI BUXHETOR RTSH	VITI 2021
Shërbimi për Shqipt.jashtë e shërb.gjuhë të huaj	50
Orkestra Simfonike RTSH dhe Kinematografisë	16
Projekte tekn.për futjen e tekn.reja(shërb. mirëmbajtjes së rrjetit të digjitalizimit)	70
Totali i kërkesave emergjente	136
Projekte teknike për futjen e teknologjive të reja investime(Digjitalizimi Arkivës së RTSH, sistemi i transmetimit FM dhe satelit)	200
Totali i kërkesave shtesë Viti 2021	336

Komisioni sugjeron që të mbështetet RTSH për kryerjen e veprimtarisë tij.

ATSH

Agjencia Telegrafike Shqiptare është një institucion klasik dhe unik i medias publike, që informon publikun nëpërmjet zhanrit më klasik, lajmit pa asnjë koment dhe deformim, lajm që shpërndahet jo vetëm në shqip, por edhe në anglisht dhe frëngjisht. ATSH prodhon mesatarisht 300 lajme shqip në ditë, 80 në anglisht dhe 50 në frëngjisht. ATSH transmeton lajme nga bota apo rajoni të marra nga agjencitë partnere, me të cilat ka marrëveshje bashkëpunimi, si agjencia prestigjioze gjermane DPA, ajo franceze AFP, italiane ANSA etj..

Duke ndjekur modelin e shumë agjencive të rëndësishme botërore, ATSH synon që përmes lajmeve të jetë kontributor i diplomacisë ekonomike, duke informuar mbi ligjet, aktet e rëndësishme për çështjen e investimeve, tregun shqiptar të kapitaleve, resurset turistike që paraqet vendi ynë.

ATSH kërkon shtesë rreth 2,000,000 lekë në buxhetin e vitit 2021 për rinovimin e sistemit teknologjik, duke siguruar blerjen e pajisjeve teknologjike, si një aparat fotografik dhe një kamera; po kështu për projektin e dytë me një kosto rreth 5,000,000 lekë për digjitalizimin e arkivës së fotografisë dhe buletinëve të shkruar.

Komisioni sugjeron që ATSH të mbështet me shtesë fondi në buxhetin e vitit 2021 në vlerën e 7.000.000 lekëve.

Qendra Kombëtare e Kinematografisë(QKK)

Në Tavanin e Programit Buxhetor Afatmesëm 2020-2022, buxheti i QKK në total për vitin 2020 ka qenë: **170,520,000 lekë.**

QKK parashikoi në fondin e investimeve të huaja një ndryshim buxheti, nga fondet tona në zërin e financimit “të projekteve kinematografike”, për tek zëri “Investime të huaja”, për të bërë të mundur realizimin e projektit “CIRCE–Interreg-IPA CBC”, e financuar në shumën 13,400,000 lekë, e cila do përdorej për blerjen e dy aparatave për shfaqje filmi për pajisjen e kinemave të Vlorës dhe të Gjirokastrës. Këto fonde do të na rimburohen nga fondet e projektit IPA, pas mbylljes së projektit në vitin 2021.

Përsa i përket Buxhetit të vitit 2021, për QKK është parashikuar 158,000,000 lekë. QKK nuk ka parashikuar në buxhetin e vitit 2021 shtesën prej 13,400,000 lekë, sepse me përfundimin e projektit, këto fonde pritet t`u rimburohen.

QKK kërkon që këto fonde të cilat do të rimburohen për vitin 2021 nga fondet e projektit IPA, t`i shtohen tavanit të vitit 2021 në zërin e financimit “të projekteve kinematografike”

Komisioni sugjeron që QKK-së ti shtohen 13,400,000 lekë

Drejtoria e Përgjithshme e Arkivave

Në përgatitjen e projektbuxhetit afatmesëm 2021-2023 për Drejtorinë e Përgjithshme të Arkivave, në zërin 602 të shpenzimeve operative është dërguar në Kuvend 35.8 milionë, 7 milionë më pak ose me **një ulje rreth 17%** nga tavanet përgatitore buxhetore.

Drejtoria e Përgjithshme e Arkivave të Shqipërisë, duke u mbështetur në implementimin e prioritetëve të filluara në 3-4 vitet e fundit për këtë institucion, ka përdorur me efektivitet buxhetin e planifikuar deri tani, ka planifikuar për vitet e ardhshme nëpërmjet Marrëveshjeve Kuadër e Kontratave rreth 12 milionë lekë për digitalizimin e rreth 3 milionë dokumentave në vit, rreth 5 milionë lekë për kuti e dosje speciale për ruajtje të përhershme të fondeve arkivore, rreth 3 milionë lekë për vëzhgimin me kamera e sisteme alarmi për sigurinë e mbrojtjen e fondeve arkivore dhe ndërtesave në Tiranë e gjithë vendin, si dhe rreth 3 milionë lekë për pastrimin e higjienën e institucionit. DPA administron 18 godina në të gjithë Shqipërinë dhe ky buxhet është i domosdoshëm për arritjen e objektivave elementare të saj.

Për Drejtorinë e Përgjithshme të Arkivave, kërkohet : nga 35.8 milion lekë në buxhetin e ardhur për miratim në Kuvend, të jetë 44.8 milionë lekë, si një nevojë bazike për ofrimin e shërbimeve elementare për studiuesit e qytetarët.

Komisioni sugjeron që të mbështetet kërkesa e Drejtorisë së Përgjithshme të Arkivave për të realizuar veprimtarinë e saj.

Universitetet publike

Në seancat dëgjimore të organizuara me universitetet publike të Tiranës dhe të rretheve, drejtuesit e tyre kërkuan mbështetje në buxhet për vitin 2021.

Universiteti i Mjekësisë kërkon shikimin e mundësive për financimin e projekteve të mëposhtëme:

-Rikonstrukcioni i dy godinave të dëmtuara nga tërmeti, të mbyllura bazuar në ekspertizën e institucioneve përkatëse, që kanë kryer vlerësimin e shkallës së dëmtimit dhe të sigurisë. Shtesë e jashtme për fakultetin e Mjekësisë Dentare, si dhe shtesë kati mbi godinat egzistuese në Fakultetin e Shkencave Mjekësore Teknike.

- Zhvillimi dhe krijimi i kushteve bashkëhore për salla, laboratorë dhe ambiente të tjera studimi kërkon zgjerimin e kapaciteteve ekzistuese. Këto dy projekte do t'i shërbejnë pikërisht këtij qëllimi. Për realizimin e shtesës së jashtme për Fakultetin e Mjekësisë Dentare, kërkohet një bashkëpunim ndërmjet UMT-së , MASR-së dhe Ministrisë së Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale.

Universiteti Bujqësor i Tiranës kërkon:

Garantimin e financimit të Pagave dhe Sigurimeve Shoqërore e Shëndetësore të Stafit Akademik, ndihmësakademik dhe administrativ të Universitetit Bujqësor të Tiranës për sigurimin e mbarëvajtjes së aktivitetit të UBT_së; shtesë fondi për Bankën Gjenetike; të fillojë sa më shpejt ndërtimi i godinës së Bioteknologjisë; për vitin tjetër të financohet ngritja e një spitali kafshësh.

Universiteti i Sporteve i Tiranës

Në vitin 2021 në grandin e mësimdhënies duhen 300 307 mijë lekë; në grandin e politikave të zhvillimit (fondi i mbështetjes së institucionit dhe infrastrukturës akademike dhe fondin e projekteve konkurruese) kërkohet mbështetje për kërkimin shkencor, pasi ka vite që nuk kanë pasur asnjë financim nga grandin për kërkim shkencor dhe financimin e projekteve.

Tre janë shtyllat kryesore që kërkon mbështetje Universiteti i Sporteve të Tiranës: plotësimi i kërkesave nga granditë e mësimdhënies; miratimi i investimeve të rëndësishme për vitin 2021; financimi për kërkimin shkencor për vitin 2021.

Universiteti “Aleksandër Xhuvani” Elbasan kërkon rritjen e investimeve, mbështetjen e projekteve kërkimore shkencore.

Universiteti “Luigj Gurakuqi” Shkodër kërkon ndërtimin e një godine për Infermierinë, pasi ka rritje të numrit të studentëve vitet e fundit.

Universiteti “Aleksandër Moisiu” Durrës kërkon: ndërtimin e një konvikti për studentët që nuk banojnë në Durrës; fonde për kërkimin shkencor; fonde për përshtatjen e procesit të mësimdhënies online.

Universiteti “Ismail Qemali” Vlorë kërkon fonde për ndërtimin e godinës së shëndetit public.

Universiteti “Eqrem Çabej” Gjirokastrë kërkon të mbështetet me fonde për rikonstrukcionin e godinës së ushtarakëve në vlerën prej 10.141.000 lekë nga Buxheti i Shtetit.

IV. DISKUTIMI NË KOMISION

Në diskutimin në parim për projektligjin “Për Buxhetin e Vitit 2021” gjatë seancave me ministrinë e linjës dhe institucionet e tjera, gjërësisht për projektligjin diskutoi relatorja, znj. Lindita Nikolla, e cila në mes të tjerash u ndal në kushtet kur diskutohet ky buxhet, qëndrueshmërinë e tij, përmbushjen e Programit të Qeverisë Shqiptare, të prioriteteve të saj, ku arsimit, kultura, shkenca, sporti e rinia kanë vëmendje të veçantë, gjë që shprehet, në mes të tjerash, në rritjen e buxhetit në disa drejtime. Shprehën mendimet e tyre në mbështetje të projektligjit “Për Buxhetin e Vitit 2021”, deputetët Ramazan Gjuzi, Mirela Kumbaro, Fidel Ylli, Musa Ulqini, Ismet Beqiraj, Fadil Nasufi, Adelina Rista, si dhe deputetë të tjerë të mazhorancës, ndërsa ishin kundër projektligjit “Për Buxhetin e Vitit 2021” deputetët Fatjona Dhimitri dhe Erion Piciri.

V. PËRFUNDIM.

Në përfundim, Komisioni për Edukimin dhe Mjetet e Informimit Publik, duke vlerësuar projektligjin “Për Buxhetin e Vitit 2021” në tërë komponentët e tij, me shumicë votash miratoi në parim projektligjin dhe i paraqet Raportin e tij Komisionit për Ekonominë dhe Financat.

RELATORE

Lindita NIKOLLA

KRYETAR

Ramazan GJUZI



**REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KUVENDI**

Komisioni për Edukimin dhe Mjetet e Informimit Publik

(Dekument Parlamentar)

Tiranë, më ____ . ____ .2020

RAPORT

**PËR DISKUTIMIN NEN PËR NEN DHE NË TËRËSI TË PROJEKTLIGJIT
“ PËR BUXHETIN E VITIT 2021”**

Hyrje

Komisioni për Edukimin dhe Mjetet e Informimit Publik, në cilësinë e Komisionit për dhënie mendimi, në mbledhjen e tij, online, të dates 9.11. 2020, mori në shqyrtim nen për nen dhe në tërësi projektligjin “Për Buxhetin e Vitit 2021”, propozim i Këshillit të Ministrave.

Relatore e projektligjit është znj. Lindita Nikolla.

Në mbledhjet e Komisionit, gjatë diskutimit nen për nen ishin të pranishëm drejtuesit e sindikatave të arsimit parauniversitar dhe universitar, si dhe të Qendrës për Arsim Cilësor.

I. BAZA KUSHTETUESE E PROJEKTLIGJIT

Projektligji i paraqitur për shqyrtim është nismë e Këshillit të Ministrave, sipas përcaktimeve të neneve 81-83, të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë dhe shoqërohet me relacionin përkatës, sipas nenit 80 të Rregullores së Kuvendit.

II. QËLLIMI, PËRMBAJTJA DHE RISITË E PROJEKTLIGJIT

2.1. Qëllimi i projektligjit:

Për përmbajtjen e projektligjit “Për Buxhetin e Vitit 2021”, propozim i Këshillit të Ministrave, Komisioni është shprehur gjërësisht gjatë diskutimit në parim të tij.

Sipas relacionit shoqërues që në fillim theksohet se Projektbuxheti 2021 synon rimëkëmbjen ekonomike të vendit, pas dy fatkeqësive natyrore, si tërmeti i 26 nëntorit 2019 dhe pandemia e shkaktuar nga COVID -19. Rimëkëmbja do të realizohet përmes skemave të punësimit, mbështetjes pro-aktive ndaj biznesit, rindërtimit të plotë të banesave të qytetarëve të prekur nga tërmeti, si dhe marrjen e masave parandaluese të përhapjes së mëtejshme të COVID-19 etj.

Në vitin 2021, të ardhurat totale të buxhetit të shtetit parashikohen të arrijnë **479 miliardë lekë**, nga këto, të ardhurat tatimore 437 miliardë lekë dhe brenda zërit të të ardhurave tatimore, të ardhurat që mblidhen nga tatimet dhe doganat 311 miliardë lekë. Ndërkohë, të ardhurat nga kontributet planifikohen 99,7 miliardë lekë.

Krahasuar me të pritshmin e vitit 2020, të ardhurat gjithsej të buxheti të shtetit rriten 10.6 %, ndërkohë që të ardhurat tatimore nga tatimet dhe doganat programohen të rriten 12.2 % ose +37.1 miliardë lekë.

2.2. Risitë e projektligjit

Risitë e projektligjit reflektohen në një sërë treguesish të projektbuxhetit të Vitit 2021.

Menaxhimi i pandemisë Covid-19 nga Qeveria Shqiptare, alokimit të fondeve dedikuar këtij menaxhimi, do ndikojë në forcimin e sistemit shëndetësor në vendin tonë. Mjafton të përmendim faktin se për këtë qëllim qeveria alokoi në vlerën 2.4 miliardë lekë nga Buxheti i Shtetit për Ministrinë e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale për vitin 2020, shumë kjo që u rrit me rreth 507 milionë lekë ndihma, kryesisht nga organizatat ndërkombëtare në pajisje mjekësore, materiale mbrojtëse dhe medikamente.

Riparimi i dëmeve të shkaktuara nga pasojat e tërmetit të 26 nëntorit, pasoja që u shtrin në hapësirën e 11 bashkive, përfshirë dy më të mëdhatë ë të populluarat si Tirana dhe Durrësi, si dhe bashkitë më të prekura ishin gjithashtu Shijaku, Kruja, Kamza, Kavaja, Kurbini, Lezha, Rrogozhina dhe Mirdita.

Pas recensionit të fortë në vitin 2020, ekonomia pritet të rrekuperohet në vitin 2021 dhe të vijojë trendin pozitiv në periudhën afatmesme.

Rritja ekonomike dhe punësimi, do të mbështetet edhe nga objektivi tjetër i planifikuar në këtë buxhet, ai i sigurimit të një niveli të lartë të **investimeve publike prej 7.2% e PBB.**

Buxheti i MASR 2020.

Fondet për sektorin e arsimit në vitin 2021 janë 75 miliardë 850 milionë lekë, duke pësuar rritje prej 36.3% në krahasim me 2020. Fondet përfaqësojnë 12.9% ndaj shpenzimeve të buxhetit apo 4.51 % ndaj produktit brendshëm bruto.

Buxhetit të MASR-së për vitin 2021 do ti shtohet edhe shtesa e pagave prej 15% për të gjithë punonjësit mësimore, e cila është planifikuar të fillojë nga data 1 Janar 2021

Për arsimin parauniversitar

Fondet për arsimin paruniversitar janë 58 miliardë e 352 milionë lekë, rritje prej 35.9% në krahasim me 2020.

Në arsimin parauniversitar për periudhën afatmesme 2021-2023 synohet sigurimi i rritjes së aksesit të fëmijëve në arsimin parashkollor në masën 86%, ndjekja e arsimit bazë (nga 100% e moshës 6-16), përfshirja me përparësi e grupeve vulnerable, ofrimim e teksteve shkollore falas për nxënësit që ndjekin arsimin bazë, (në vitin 2021 do përfshihen në skemë edhe nxënësit e klasës 8 dhe 9), si dhe tekste shkollore falas për nxënësit nga shtresa sociale në nevojë në arsimin e mesëm të lartë, shtimi në vitin 2021 i 400 edukatoreve, shtimi i mësuesve ndihmës, trajnimi çdo vit 9.000 mësuesve të klasa 4 dhe klasës 9 për kurikulën e re; krijimit të një infrastrukture të qëndrueshme, gjerësisht të përdorshme të burimeve digjitale në shkollat; hartimin e programeve specifike për arsimimin e grupeve të pafavorizuara. Deri në vitin 2022, çdo fëmijë rom dhe egjiptian, do të regjistrohet në shkollë, 100% e tyre do të mbarojnë arsimin e detyruar dhe 70% më shumë vajza e djem romë dhe egjiptianë do të përfundojnë të gjitha nivelet e arsimit; rikonstrukcion, rindërtimin, ndërtime të reja të objekteve arsimore në Tiranë, Durrës dhe Lezhë nga fondi i Rindërtimit etj

Arsimi profesional dhe punësimi

Buxheti i planifikuar për Programin e Arsimit të mesëm profesional, për vitin 2021 është 3 miliardë e 295 milionë lekë me një rritje me 4.1% më shumë se vitin e kaluar.

Programi Buxhetor i Arsimit të mesëm profesional për vitin 2021 synon të përmbushë objektivat e vendosura në Strategjinë Kombëtare të Punësimit dhe Aftësive 2019 –2022 në planin e veprimit të saj për fushën e AFP –së.

Realizimi i një procesi mësimor cilësor; rishikimi i programeve ekzistuese dhe hartimi i programeve të reja në përputhje me parimet e barazisë gjinore dhe gjithpërfshirjes; rritjen e numrit të nxënësve me aftësi të kufizuara, që ndjekin studimet në shkollat e mesme profesionale etj; rritjen e numrit të të punësuarve pas diplomimit në shkollat e mesme profesionale ; Në vitin 2021 do ketë rikonstrukcione të reja të shkollave “Hoteleri Turizëm” dhe shkollës “Herman Gmainer” në Tiranë; do vijojë rikonstrukcioni i shkollave të mesme profesionale "Beqir Çela", Durrës; “Sali Ceka”, Elbasan, “26 Marsi” Kavajë, “Nazmi Rushiti” Peshkopi etj.

Për arsimin e lartë dhe kërkimin shkencor

Për vitin 2021, buxheti i arsimit të lartë dhe kërkimit shkencor (pa përfshirë fondet jashtë buxhetore) është planifikuar në një vlerë totale prej 11 miliardë e 476 milionë lekësh

Buxheti 2021i MASR për programin buxhetor “**Arsimi i Lartë**” ka shënuar një **rritje prej 7,6% ose 767 milionë lekë** më shumë se buxheti 2020, rritje e cila është orientuar kryesisht në shpenzimet kapitale, të cilat **janë rritur me 84%** krahasuar me vitin 2020. Gjithashtu edhe buxheti i vitit 2021 i MASR për programin buxhetor “**Kërkimi Shkencor**” ka një **rritje me 25,9% ose 140 milionë lekë** më shumë krahasuar me vitin 2020.

Prioritetet e Qeverisë në arsimin e lartë :”Pakti për Universitetin” synon : rritja e cilësisë së mësimdhënies nëpërmjet kualifikimit shkencor të stafit akademik;financimi me përparësi për ngritjen e infrastrukturës dhe investimet në kampuset universitare;fondi i mbështetjes studentore, për të mbuluar shpenzimet për bursat e studentëve nga shtresat sociale në nevojë, si dhe studentëve ekselencë në IAL publike, si dhe përjashtimi apo reduktimi nga tarifave vjetore e shkollimit për studentët e ekselencës apo studentët të kategorive sociale në nevojë; vazhdim i ndërtimit të godines së Fakultetit të Inxhinierisë së Ndërtimit dhe Inxhinierisë Elektrike & Mekanike, Universiteti Politeknik; vazhdimi i ndërtimit godinës së Fakultetit të Bioteknologjisë në Universitetin Bujqësor; Fonde grand për IAL-të publike për të financuar përmirësimin e infrastrukturës në IAL-të publike për projekte të reja ;Në vitin 2021 është parashikuar të fillojnë projektet për ndërtimin e Kampusit të Universitetit të Tiranës, Universitetit të Arteve dhe Akademisë së Rendit, për sigurimin e kushteve më të mira për studentët në kuadër të “Paktit për Universitetin”.etj

Për sportin dhe rininë për periudhën 2021-2023 prioritet do të jetë;

Edukimi nëpërmjet sportit si një faktor efikas në përmirësimin e shëndetit e të mirëqenies për qytetarët, përmes sigurimit të një shërbimi cilësor, nëpërmjet sportit elitare dhe sportit në tërësi;sigurimi i mbështetjes financiare për federatat Olimpike në aktivitete ndërkombëtare, mbështetja financiare për Ekipin Kombëtar Olimpik pjesëmarrës në Lojërat e Olimpikëve Japoni 2021;mbështetja financiare me investime në sport;

Për vitin 2021 një miliardë shtesë vetëm grandit i federatave, duke u shtuar nga 100 milionë lekë në 200 milionë, pra me një rritje 100 % buxheti i federatave. Nga 94 milionë lekë këtë vit, në vitin 2021 do ketë 300 milionë lekë për investime ose 285 milion lekë më shumë;përmirësim i cilësinë e jetës së të rinjve etj.

Buxheti për Ministrinë e Kulturës

Programi Kombëtar “Edukimi përmes Artit” do të jetë vijimi i një reforme të thellë dhe të qëndrueshme në institucionet e artit dhe politikave kulturore, duke vënë theksin në rëndësinë dhe rolin e edukimit përmes kulturës në kohezionin social, i provuar tashmë në vende të tjera.

Përmirësimi i gjendjes fizike të monumenteve të kulturës përmes ndërhyrjeve të vazhdueshme në të gjithë vendin, përmirësimi i infrastrukturës në Muzetë Kombëtarë, Parqe Arkeologjike; edukimi përmes librit dhe veprimtarive bibliotekare, pasurimi i fondit bibliotekar në të gjithë rrjetin e bibliotekave në mbarë vendin, me qëllim rritjen dhe edukimin e lexuesit;ritjen e aksesit të publikut në Muze, monumentet e kulturës, ansambleve arkitektonike, qyteteve muze, qendra historike, zonave dhe parqeve arkeologjike, në funksion të turizmit kulturor.

Për Trashëgiminë kulturore

Restaurimi dhe mirëmbajtja e trashëgimisë arkitektonike dhe peisazhit, duke përfshirë restaurimin e disa linjave muzeale, si edhe përshtatjen me standarde bashkëkohore. Rritja e numrit të objekteve të trashëgimisë arkitektonike dhe peisazhit të restauruara dhe mirëmbajtura nga 130 në vitin 2020 në 185 në vitin 2023; vijimi dhe rikonstruksioni i Kishës së Shën Ilias në fshatin Stegopull në Gjirokastrë, kishës së Shenepremtes në fshatin Dajç;perdorimi i fondit të rindërtimit për financimin e restasurimit e rindërtimit të pasurive kulturore në vlerën prej 236, 6 milionë lekë,për të cilin janë hartuar 38 projekte;vijimi i mbështetjes financiare për projektet në fushën e

artizanatit, kulinarisë dhe dukurive të tjera të trashëgimisë jomateriale, veçanërisht për gratë artizane (30% ndaj totalit të përfituesve) etj

Për Artin dhe Kulturën

Rritja e aksesit në kulturë, e cila parashikon një rritje të vazhdueshme të numrit dhe cilësisë së aktiviteteve në të gjitha zhanret. Rrjet aktivitetesh që synojnë në konsolidimin e vlerave artistike, promovimin e Artit Shqiptar në arenën ndërkombëtare, mbështetja e aktiviteteve kulturore në mbarë vendin nëpërmjet thirrjeve për aplikime në fushën e artit dhe kulturës, librit dhe përkthimit; Prioritet do të jetë integrimi, angazhimi dhe promovimi i të rinjve më të evidentuar të kësaj fushe; mbështetja e 80 projekteve me thirrje në mbështetje e industrive krijuese duke respektuar barazinë gjinore, të drejtat e njeriut, grupet e marginalizuara dhe diversitetin kulturor në rang vendi etj.

III. KONSULTIMI PUBLIK I PROJEKTLIGJIT

Komisioni mbështetur në nenin 36, pika 1 dhe nenin 80, pika 2 të Rregullores së Kuvendit, pas organizimit të disa seancave dëgjimore gjatë diskutimit të projektligjit në parim me ministrinë e linjës, Akademinë e Shkencave, Akademinë e Studimeve Albanologjike, RTSH, ATSH, QKK, Drejtorinë e Përgjithshme të Arkivave, si dhe universitetet publike të Tiranës dhe ato të rretheve, në vijim të këtij procesi në diskutimin nen për nen dhe në tërësi, në kuadër të gjithëpërfshirjes, transparencës dhe konsultimit publik, organizoi seanca dëgjimore me sindikatat e arsimit si: Federata e Sindikatave të Arsimit dhe Shkencës të Shqipërisë; Sindikata e Pavarur e Arsimtarëve; Sindikata e punonjësve të Universiteteve të Shqipërisë: Qendra "Per Arsim Cilesor".

Në emër të Federatës së Sindikatave të Arsimit dhe Shkencës (FSASH), kryetari saj, zotit Isa Rekaj, në mes të tjerash, theksoi:

"Ky buxhet i përket një viti krize dhe në këtë këndvështrim e cilësoi atë optimist; vlerësoi rritjen e pagave të mësuesve në masën 15%, por vuri në dukje se vazhdon të jetë e ulët përqindja e buxhetit për arsimin në raport me prodhimin e brendshëm bruto; kërkoi që në arsimin parauniversitar të ketë mjete bashkëkohore mësimore, siç janë pajisja e çdo klase me një laptop e videoprojektor; po kështu u ndal në çeshtje që lidhen me transportin e mësuesve, sakrificën e tyre në kushtet e pandemisë, mësimdhënien në distancë, shtesën në buxhetin e këtij sistemi arsimor, si dhe kërkoi nga institucionet përgjegjëse në nivel qendror e vendor, si dhe aktorët e tjerë, zbatimin me përpikmëri të Protokollit Antipandemi, Covid-19".

Sindikata e Pavarur e Arsimit të Shqipërisë, përmes Presidentit të saj, zotit Nevruz Kaptelli, parashtoi mendimin për Projektligjin "Për Buxhetin e Vitit 2021".

Sipas tij, "Buxheti i ulët, mungesa e investimeve publike në arsim, tërmeti i 26 nëntorit 2019, pandemia dhe shpenzimet e pamjaftueshme të Qeverisë, për arsim cilësor dhe gjithëpërfshirës, vijnë ende të lënë pa u arsimuar një pjesë jo të vogël të fëmijëve. Nga rreth 480 mijë fëmijë në arsimin parauniversitar, disa mijëra në gjithë vendin nuk shkojnë në shkollë, për arsye nga më të ndryshmet, ku më kryesorja është gjendja e vështirë ekonomike, që i detyron të

braktisin shkollën dhe të punojnë, nga të cilët më të shumtët në numër rezultojnë fëmijët e komuniteteve romë dhe egjiptiane.

Me gjithë kërkesat e përvitshme të SPASH për rritjen e buxhetit për arsimin nga afro 3% që është sot në 5% të GDP dhe dhënien e librave falas për arsimin e detyrueshëm, ende një pjesë e konsiderueshme e nxënësve në arsimin e detyrueshëm nuk i përfitojnë ato falas.

Në arsimin e mesëm të përgjithshëm dhe profesional të gjithë nxënësit romë, egjiptianë dhe ata me aftësi të kufizuara nuk marrin tekstet falas edhe pse pjesa më e madhe e familjeve të tyre jetojnë nën minimumin jetik të varfërisë. Mospajsa me tekste shkollore falas e këtyre nxënësve ndikon drejtpërsëdrejti në mosndjekjen rregullisht të shkollës, braktisjen e saj dhe një sërë fenomenesh të tjera ku një pjesë të tyre i fut në rrugën e kimit.

Edhe arsimi i lartë përballet prej vitesh me pamjaftueshmëri fondesh, që kanë sjellë probleme nga më të ndryshmet, por mbi të gjitha kanë ndikuar në shtimin e pagesave të vetë studentëve, duke veshtirësuar përbalimin e shkollimit të tyre” etj. Njëkohësisht trajtoi dhe disa çeshtje të tjera, që lidhen me rritjen e pagave të mësuesve, rritjen e cilësisë, trajnimin e tyre, transportin, shërbimin teknologjik etj.

Sindikata e punonjësve të universiteteve të Shqipërisë, përfaqësuar nga kryetari saj, Prof.Asoc.Dr. Sandër Kovaçi, parashtrori kërkesat e poshtëshënuara:

Rritjen e pagave për pedagogët dhe stafin ndihmës shkencor e administrativ; rritjen e pagesës së orëve suplementare për pedagogët e brendshëm(PAE) dhe pedagogët e jashtëm me kontratë(PAK); rivlerësimin e orës mësimore; rishikimin e tatimit prej 23% mbi realizimin e ngarkesës mësimore suplementare; pagesa për orët suplementare të mos trajtohej si pagë, por si honorar dhe si e tillë mund të trajtohej 15% si tatim në burim; rivendosjen e shtesave mbi pagë "për dëmshëri shëndeti në punë" për laborantët dhe stafin akademik që punojnë në laboratore , në kontakte me "substancat të rrezikshme dhe preparate të tjerë" etj.

"Qendra për Arsim Cilësor" , përmes Drejtores Ekzekutive të saj, znj. Altea Lula, kërkoi të rritet financimi për vitin 2021 për arsimin parauniversitar në dy programe: programin e arsimit bazë dhe programin e arsimit të mesëm të përgjithshëm, si dhe të rritet financimi për trajnime falas për gjithë mësuesit.; të shtohen mësuesit ndihmës, por edhe të rritet cilësia e tyre; të rritet kujdesi për fëmijët me aftësi të kufizuara dhe për klasat ku këta fëmijë zhvillojnë mësim; të ketë mësues ndihmës të specializuar dhe kualifikuar në fushën përkatëse; sipas saj, vetëm një numër shumë i vogël mësuesish mund të jenë arsimuar dhe profilizuar në pedagogji speciale; të rritet aksesin në arsim, pasi përqindja e fëmijëve në arsimin parashkollor mbetet e ulët dhe larg objektivave të përcaktuar nga MASR; të arrihet objektivi në një përqindje 100% të aksesit në shkollë nga të gjithë fëmijët dhe frekuentimi e mos braktisja nga nxënësit, në veçanti vajzat, grupet vunerabël dhe ata me vështirësi ekonomike etj.

IV. DISKUTIMI NË KOMISION

Në diskutimin nen për nen të projektligjit “Për Buxhetin e Vitit 2021”, gjatë seancave dëgjimore me drejtuesit e Federatës së Sindikatave të Arsimit dhe Shkencës(FSASH), Sindikatës së Pavarur të Arsimit të Shqipërisë,Sindikatës së punonjësve të universiteteve të Shqipërisë, “Qendrës për Arsim Cilësor”, si dhe gjatë shqyrtimit nen për nen e në twrësi të projektligjit, veçanërisht u ndal relatorja, znj. Lindita Nikolla, e cila vlerësoi rolin e sindikatave, sidomos, për sistemin arsimor parauniversitar; në mënyrë analitike trajtoi projektbuxhetin e vitit 2021, kushtet në të cilat ndodhet vendi, vështirësitë e vitit 2020 dhe në vijim nga pandemia Covid-19, si dhe pasojat e tërmetit të 26 nëntorit, përkushtimin e Qeverisë Shqiptare për kapërcimin e situates dhe propozimin e një projektligji efektiv “Për Buxhetin e Vitit 2021”, risitë e tij, prioritetet, ku pamëdyshje arsimit, shkenca, kultura, sporti e rinia kanë vëmendje të veçantë, gjë që reflektohet dhe në trendin rritës të tij edhe në vitin 2021 etj.

Relatorja, znj.Linditas Nikolla u ndal dhe në problemet e ngritura nga drejtuesit e sindikatave të arsimit dhe “Qendra për Arsim Cilësor” për çeshtje të buxhetit dhe transportit të mësuesve dhe nxënësve, të kompetencave që u jep ligji arsimit të lartë universiteteve , rritjes së grandit për universitetet, praninë e mësuesve ndihmës fillimisht në Universitetin “Ismail Qemali”Vlorë dhe më pas në universitete të tjera, të cilët janë shtuar falë buxhetit në rritje gjatë qeverisjes së kësaj mazhorance etj.

Në fund për zgjidhjen e disa problemeve të ngritura relatorja propozoi organizimin e tre seancave dëgjimore si:

- a) Dëgjesë me Ministren e Arsimit, Sportit dhe Rinisë dhe Ministren e Infrastrukturës dhe Energjisë për buxhetin dhe tarifatat e transportit të mësuesve dhe nxënësve.
- b) Dëgjesë me Ministren e Arsimit dhe përfaqësues të Bordeve të Administrimit në universitete për pagat dhe orët suplementare të pedagogëve.
- c) Dëgjesë me MASR për trajnimin e mësuesve ndihmës në veçanti dhe mësuesve në tërësi.

Të gjitha propozimet u miratuan nga gjithë deputetët e pranishëm në mbledhjen e Komisionit.

Zv/Kryetarja e Komisionit, znj. Mirela Kumbaro, në diskutimin e saj, në mes të tjerash, vuri në dukje se duhet të jemi konkret, të mos bëjmë shumë teori, aq më tepër që një pjesë e deputetëve vijnë nga një bagazh arsimor, që kanë dhënë mësim prej vitesh dhe e njohin gjendjen. Evidentoi faktin se në këto 7-8 vjet qeverisje të mazhorancës është realizuar një revolucion, veçanërisht në arsimin parauniversitar, rritjen e sistemit dixhital; përmes Portalit “Mësues për Shqipërinë”, tashmë fituese janë aftësitë profesionale të konkuresit dhe nuk ka më deputet, kryebashkiak apo kushdo politikan tjetër të ndërhyjë në emërimet mësuesish, gjë që vijoi dhe me pranimin e infermiereve, si dhe drejtorëve të arsimit etj, që patjetër do sjellin cilësi . Njëkohësisht u ndal dhe në mbylljen e “kioskave”, siç i cilësoi universitetet e tipit “Vitrina”, etj dhe rritjen e cilësisë së arsimit në institucionet e arsimit parauniversitar dhe universitar etj. Po kështu trajtoi vëmendjen e Qeverisë Shqiptare për rindërtimin e shkollave nga pasojat e tërmetit të 26 nëntorit të vitit 2019 etj.

Deputeti Erion Piciri vuri në dukje rolin e sindikatave, vlerësoi parashtrimin e kërkesave të tyre. Ai e quajti buxhetin e ulët për arsimin, që sipas tij është 2.7% të PBB, që është më i ulët i Evropës dhe në ende nuk e kalojmë 3% që ta kthejmë arsimin në prioritet e të rrisim cilësinë, të marrin studentët diploma dinjitoze; kërkoi të investohet fuqishëm tek mësuesit e pedagogët, qoftë edhe me trajnime falas. Ky lloj buxheti, vijoi deputeti Piciri, nuk është buxhet i zhvillimit, jo vetëm për këtë qeveri, por për të gjitha qeveritë e deri tanishme, ndaj kërkoi të investohet fuqishëm në arsim, të investohet tek mendja e njeriut etj. Duke adresuar kritika ndaj qeverisë së sotme dhe buxhetit të vitit 2021 në fushën e arsimit, solli në vëmendje veçanarisht përvojën izrailite për rritjen e cilësisë në arsim etj.

Deputeti Ismet Beqiraj cilësoi dëgjesat me sindikatat pozitive, vlerësoi se ky buxhet i vitit 2021 është mjaft shpresëdhënës sidomos për institucionet e arsimit të lartë. Ai u ndal në “Paktin për Universitetin”, theksoi se nuk mund të ketë universitet pa botë akademike, punonjës ndihmës e student; evidentoi financimet për projektin në vazhdim të Kampusit të Universitetit të Tiranës, Universitetit të Arteve dhe Akademisë Policisë etj. Deputeti Beqiraj trajtoi dhe çështje të tjera që lidhen me financimin e institucioneve të arsimit të lartë që kanë të bëjnë: - me rritjen e pagave, rivlerësimin e orëve suplementare të personelit akademik të brendshëm dhe të ftuar (të jashtëm), - rivlerësim të orëve mësimore, seminare, laboratore dhe praktika mësimore në nivelet siç kanë qenë; shpërblimet për orët suplementare për pedagogët e brendshëm e ato të jashtëm të tatonen si honorar direkt në burim dhe jo si pagë, si dhe të jepet gjatë vitit akademik; - propozon akte nënligjore për rikthimin e dëmshmërisë në punë

Deputeti Musa Ulqini duke vlerësuar rolin e sindikatave në fushën e arsimit, u ndal kryesisht në objektivitetin e disa prej tyre, por kërkoi që duhet zbatuar sensi i masës edhe nga ndonjë drejtues sindikate, pasi ai është një rregull i artë; nuk rriten kreditet duke aplikuar gjithnjë vetëm kritika për gjëra që janë jashtë mundësive të realizimit.

Deputetët Erion Piciri dhe Fatjona Dhimitri u shprehën kundër miratimit të projektligjit “Për Buxhetin e Vitit 2021” edhe gjatë diskutimit të tij nen për nen e në tërësi të tij.

Komisioni u ndal në kërkesat e institucioneve për shtesa në buxhet për vitin 2021:

Akademia e Shkencave për realizimin me efektivitet të veprimtarisë saj kërkon shtesë fondi prej 20 milionë lekësh.

Komisioni sugjeron të mbështetet kërkesa e Akademisë për shtesë 20 milionë lekë.

Akademia e Studimeve Albanologjike për zhvillimin normal të veprimtarisë saj ka kërkuar një fond në buxhetin e vitit 2021 prej 95.500.000 lekë.

Komisioni sugjeron të mbështetet kërkesa për funksionimin dhe rritjen e nivelit kërkimor shkencor në këtë institucion.

RTSH

Për projektligjin “Për Buxhetin e Vitit 2021”, RTSH kërkon shtesë në buxhet në shumën 336 milionë lekë, të cilët do përdoren për programin “Shërbimi për shqiptarët jashtë kufirit e shërbimi në gjuhë të huaj; për programin Orkestra Simfonike e RTSH-së; për projekte teknike për

futjen e teknologjive të reja “për shërbimin e mirëmbajtjes së rrjetit të digjitalizimit”; për projekte afatgjata Teknike për Futjen e Teknologjive të Reja Investime (Digjitalizimi i Arkivës RTSH sistemi transmetimit FM dhe satelit)

Komisioni sugjeron që të mbështet RTSH për kryerjen e veprimtarisë tij.

ATSH

Në zërin “Shpenzime Kapitale të Trupëzuara”, ATSH, ka kërkuar shtesë rreth 2,000,000 lekë për blerjen e pajisjeve të reja teknologjike, për shkak të amortizimit dhe 5,000,000 lekë për projektin e digjitalizimit të arkivës së fotografisë dhe buletinëve të shkruar.

Komisioni sugjeron që ATSH të mbështetet me shtesë fondi në buxhetin e vitit 2021 në vlerën 7.000.000 lekë

Qendra Kombëtare e Kinematografisë (QKK)

QKK nuk ka parashikuar në buxhetin e vitit 2021 shtesën prej 13,400,000 lekë sepse me përfundimin e projektit, këto fonde pritet t’u rimbursohen.

QKK kërkon që këto fonde të cilat do të rimbursohen për vitin 2021 nga fondet e projektit IPA, t’i shtohen tavanit të vitit 2021 në zërin e financimit “të projekteve kinematografike”

Komisioni sugjeron që QKK-së ti shtohen 13,400,000 lekë

Drejtoria e Përgjithsme të Arkivave, kërkon: shuma nga 35.8 milionë lekë në buxhetin e ardhur për miratim në Kuvend, të jetë 44.8 milionë lekë.

Komisioni sugjeron që të mbështetet kërkesa e Drejtorisë së Përgjithshme të Arkivave

Universitetet publike

Universitetet publike kërkojnë rritje të buxhetit për projektet e kërkimit shkencor në të gjitha IAL-të.

Specifikisht Universiteti i Mjekësisë kërkon shikimin e mundësive për financimin e rikonstruksionit të dy godinave të dëmtuara nga tërmeti, Shtesë e jashtme për fakultetin e Mjekësisë Dentare, si dhe shtesë kati mbi godinat egzistuese në Fakultetin e Shkencave Mjekësore Teknike etj; Universiteti Bujqësor i Tiranës kërkon: garantimin e financimit të Pagave dhe Sigurimeve Shoqërore e Shëndetësore; shtesë fondi për Bankën Gjenetike; të fillojë sa më shpejt ndërtimi i godinës së Bioteknologjisë etj. Universiteti i Sporteve i Tiranës kërkon: plotësimin e kërkesave nga granditë e mësimdhënies; miratimi i investimeve të rëndësishme për vitin 2021; Universiteti “Aleksandër Xhuvani” Elbasan kërkon rritjen e investimeve; Universiteti “Luigj Gurakuqi” Shkodër kërkon: ndërtimin e një godinne për infermierinë, pasi ka rritje të numrit të studentëve vitet e fundit; Universiteti “Aleksandër Moisiu” Durrës kërkon: ndërtimin e një konvikti për studentët që nuk banojnë në Durrës; Fonde për përshtatjen e procesit të mësimdhënies online; Universiteti “Ismail Qemali” Vlorë kërkon: fonde për ndërtimin e godinës së shëndetit publik; Universiteti “Eqrem Çabej” Gjirokastrë kërkon të mbështetet me fonde për rikonstruksionin e godinës së ushtarakëve në vlerën prej 10.141.000 Lekë nga Buxheti i Shtetit

Komisioni mbështet kërkesat e universiteteve publike për realizimin e veprimtarisë së tyre akademike.

V. PËRFUNDIM

Në përfundim, Komisioni për Edukimin dhe Mjetet e Informimit Publik, duke vlerësuar projektligjin “ Për Buxhetin e Vitit 2021” në tërë komponentët e tij, me votat e shumicës deputetëve të pranishëm, miratoi nen për nen dhe në tërësi projektligjin " Për Buxhetin e Vitit 2021" dhe i paraqet Raportin e tij Komisionit për Ekonominë dhe Financat.

RELATORE

Lindita NIKOLLA

KRYETAR

Ramazan GJUZI